

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten Edona Selimi, në lëndën penale kundër të akuzuarit D.S. te cilin me autorizim e mbronë av. B.H. nga Gjilani, për veprën penale, **Lendim i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me parag.1, nenparag. 1.4 të KPRK-së, dhe te akuzuarit A.A. te cilin me autorizim e mbronë av. Sh.Sh. nga Gjilani, për veprat penale **Rrezikimi I trafikut publik nga neni 378, parag. 8 lidhur me parag. 1 te KPRKS-së, dhe Mosdhenia e ndihmes personit te lenduar ne fatkeqesinë e trafikut publik nga neni 382, parag. 2 lidhur me parag. 1 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP.II. Nr. 889/2016 të datës 20.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datën 18.04.2018, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, kurse më datë 04.05.2018 përpiloi këtë:******

## A K T G J Y K I M

1. I akuzuari D.S., nga babi B. dhe nena L., e lindur K., i lindur me date ..., ne ..., ku edhe tani jeton, Rr. “ ... ” ..., i pa martuar, student, i pa pune, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, i pa denuar me pare dhe nuk zhvillohet procedure tjeter penale ndaj tij.
2. I akuzuari A.A., nga babai L. dhe nena S., e lindur K., i lindur me date ..., ne ..., ku tani jeton ne Prishtine, Rr. “ ... ” nr. ..., i pa martuar, student, i pa pune, i gjendjes se mesme ekonomiken, Shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, i pa denuar me pare dhe nuk zhvillohet procedure tjeter penale ndaj tij.

## JANË F A J T O R Ë

Sepse,

**I. I. I akuzuari D.S., me date 15.05.2016, rreth ores 01:00, ne Gjilan, ne diskoteken “Stop”, per shkak te nje zenke te momentit, e ka lenduar lehte te akuzuarin K.L. nga Gjilani, ne ate menyre qe te njejtin e gjuan dhe godet me shishe te birres ne koke, me ç’rast te njejtin i shkakton lendime te lehta trupore ne forme te ndrydhjeve te indeve te buta te kokes dhe e ejtun me mavijosje ne regjionin ballor te kokes si dhe plageve ndrydhese qarese ne regjionin e kokes dhe gervishtjeve nen lekurore ne fytyre, me pasoja te perkohshme per shendetin.**

**-me çka ka kryer veprën penale, **Lendim i lehte trupor, nga neni 188 parag. 2 lidhur me parag. 1, nenparag. 1.4 te KPRK-së,****

**II. 2. I akuzuri A.A., me date 15.05.2016, rreth ores 01:00, ne Gjilan, ne diskoteken “Stop”, duke u kyqur ne rrugen “Lidhja e Prizrenit”, nga parkingu i marketit “Gorenje”, me automjetin e udhetareve te markes “Audi A4”, me targa te regjistrimit ..., te cilin ishte duke e drejtuar, ka shkelur paragrafin 54.1 te nenit 54 te LSKRR dhe ka rrezikuar jeten e njerezve dhe pasurine, ne ate menyre qe nuk iu eshte permbajtur dispozitave te lartepemendura te ligjit ne fjale qe kane te bejne me obligimin e shoferit qe automjetin ta ngase me shpejtesi adekuate dhe sjellje e cila i lejon qe ta kontrolloje automjetin, ne kushte ekzistuese te komunikacionit, posaçerisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmerine e rruges, kushtet dhe ngarkesen e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendesine e komunikacionit ne menyre qe mjetin e vet ta ndalë para çdo pengese, lehte ka menduar se edhe**

perkunder ketij leshimi nuk do te shkaktoj pasoje te ndaluar, ashtu qe me te arritur ne vendin e permendur, me kohe nuk ka mundur ta ndale automjetin te cilin ishte duke e drejtuar me vrulle per ta derguar sa me shpejt te mjeku D.S. per t'i ofruar ndihmen e nevojshme mjekesore, sepse te njejtit i rridhte gjaku nga lendimi qe kishte pesuar gjate konfliktit te permendur ne mes te D.S. dhe K.L., dhe per pasoje me pjesen e perparme dhe anesoret e ketij automjeti ne fillim i godet te demtuarit A.Z., G.H. dhe N.D., te gjitha nga Gjilani, e me pas edhe auto taxin "Luli" te markes "Golf VII" me tabela te regjistrimit ..., me c'rast auto taxit ne fjale i shkakton deme materiale ne vlere te pa percaktuar, kurse te demtuarit A. i shkakton lendime te renda trupore ne forme te thyerjes se kockes se parakembes (kercirit) te djathte, ndersa G. me kete rast i shkakton lendime te lehta trupore ne forme te ndrydhjeve ne parakrahun e djathte, kurse N. me kete rast i shkakton lendime te lehta trupore ne forme te ndrydhjeve te indeve te buta te gjurit dhe parakembes se majte, ne dy rastet e fundit me pasoja te perkohshme per shendetin,

- me cka ka kryer vepren penale **Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, parag. 8 lidhur me parag. 6 e 1 te KPRK-së.**

**III.** Diten, kohen dhe vendin e permendur si ne piken II te dispozitivit te ketij aktgjykimi, nuk iu ka ofruar ndihme te demtuareve qe i ka lenduar me automjetin e tij ne aksidentin e lartepemendur, edhe ate: A.Z., G.H. dhe N.D., te gjitha nga Gjilani, ne ate menyre qe godet te njejtit me automjet te cilin ishte duke e drejtuar me kete rast vrullshem dhe shume shpejt dhe me pas nuk ndalet per t'iu ofruar te njejteve ndihmen e nevojshme, por vazhdon rrugen sikurse te mos kishte ndodhur asgje,

- me cka ka kryer vepren penale **Mosdhenia e ndihmes personit te lenduar ne fatkeqesine e trafikut publik, nga neni 382, parag. 2 lidhur me 1 te KPRK-së,** andaj, Gjykata, bazuar ne dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

## **I GJYKON**

**Të akuzuarin D.S., ne baze te nenit 76, parag. 1, nenparag. 1.7 i KPRK-së me Denim gjobe ne shumen prej 600 (gjashtëqind) € , ne të cilin dënim do t'i llogritet koha ne arrest shtepiak prej dt. 15.05.2016 deri me dt.06.06.2016, keshtuqe atij do t'i mebtet qe t'i paguaj 160 (njëqindegjashtëdhjetë) €, te cilin denim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ketij aktgjykimi**

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit shqiptohet taksa në shumën prej 30 (tridhjetë) €

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 30 (tridhjetë) €, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ketij aktgjykimi.

**Të akuzuarin A.A.,**

**Per vepren e pare penale Denim me Burg ne kohezgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, ashtu që, në mbështetje të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. Sh.Sh., dënimi i shqiptuar me burg, do t'i zëvendësohet në Dënim Gjobe, në shumë prej 500 (pesëqind) €,**

**Per vepren e dyte penale Denim me Burg në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, ashtu që, në mbështetje të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. Sh.She., dënimi i shqiptuar me burg, do t'i zëvendësohet në Dënim Gjobe, në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ketij aktgjykimi.**

Ne baze te **nenit 80 te KPRK-së** te akuzuarit do t'i shqiptohet nje **Denim Unik** ne shumen prej **800 (tetëqind) €**, ne të cilin dënim do t'i llogritet koha ne arrest shtepiak prej dt. 15.05.2016 deri me dt.06.06.2016, keshtuqe atij do t'i mebtet qe t'i paguaj **360 (treqind e gjashtëdhjetë) €**, te cilin denim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit shqiptohet taksa në shumën prej **30 (tridhjetë) €**

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **30 (tridhjetë) €**, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Te dëmtuarit për kompensimin e demit material, udhëzohen në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP.II nr. 889/2016 të datës 20.05.2016, kundër të akuzuarit D.S. per vepren penale **Lendim i lehte trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me parag.1, nenparag. 1.4 të KPRK-së**, dhe te akuzuarit A.A. per veprat penale **Rrezikimi I trafikut publik nga neni 378, parag. 8 lidhur me parag. 1 te KPRK-së, dhe Mosdhenia e ndihmes personit te lenduar ne fatkeqesine e trafikut publik nga neni 382, parag. 2 lidhur me parag. 1 te KPRKS-së** dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim meritor sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 03.04.2018, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit Rozelida Manastiri, të akuzuarit D.S. dhe A.A., kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, duke deklaruar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas dëgjimit të palëve, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit D.S. dhe A.A., ngase ka ardhur në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë të parapara në nenin 248 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të gjyqtarës së vetme gjykuese, të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat janë paraqitur së bashku me aktakuzë dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, erdhi në përfundim se të akuzuarit D.S. dhe A.A. X, kanë kryer veprat penale të cilat u vihen ne barrë.

Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit patën sjellje korrekte në Gjykatë, se janë penduar për veprat në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e

përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.*

*Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 640/2016, më datë 04.05.2018**

***Praktikantja,  
Edona Selimi***

***Gjykatësja e vetme gjykuese,  
Luljete Shabani***

***KËSHILLA JURIDIKE:*** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.